



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11.02.2020

Ref: 150/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016) Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), mori:

V E N D I M

Korrigjohet vendimi i KShC-së Nr. 193/09, datë 30.07.2009 për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit – Universiteti i Prishtinës.

- I. Akreditohet programi i studimit Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë (BA), për periudhën 1 Tetor 2009 – 30 Shtator 2012.
- II. Pjesa tjetër e vendimit të KShC-së Nr. 193/09, datë 30.07.2009 mbetet e pa ndryshuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Zyra për zhvillim akademik e Universitetit të Prishtinës ka parashtruar kërkesë për korrigjim të vendimit 193/09, datë 30.07.2009.

Pas dëshmive të ofruara dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, KShC ka konstatuar se gjatë formulimit të vendimit të KShC-së Nr. 193/09, datë 30.07.2009, është bërë lëshim teknik, me ç' rast në këtë vendim nuk është përfshirë programi i studimit Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë (BA).

Prandaj përmes këtij vendimi, mbi bazën e dëshmive të ofruara, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë